xh. Gjini
P. Vendimi?

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA GRAMSH**
**DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE**
**SEKTORI I EMERGJENCAVE CIVIL DHE STREHIMIT**

Nr. 3049 .Prot Gramsh,më 21 /07/2026

# RELACION

## PËR MIRATIMIN E SHPËRNDARJES SË FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR EMERGJENCAT CIVILE NË BASHKINË GRAMSH

**I /të** nderuar **Kryetar/anëtarë** të Këshillit bashkiak

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", ligjit nr. 45/2019 "Për Mbrojtjen Civile" ,VKM nr. 414 datë 8.7.2021 "Për miratimin e procedurave dhe kritereve për përdorimin dhe shpërndarjen e fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për Mbrojtjen Civile", si dhe në bazë të shkresës së Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile me nr. prot. 429/6, datë 15.04.2026, Bashkisë Gramsh i është akorduar një fond i kushtëzuar në vlerën 9,342,128 (nëntë milion e treqind e dyzet e dy mijë e njëqind e njëzet e tetë) lekë, me kod produkti 21AD502 "Rehabilitimi i objekteve të ndryshme infrastrukturore".

Ky fond është akorduar me destinacion të përcaktuar dhe do të përdoret për financimin e ndërhyrjeve prioritare në infrastrukturën publike të dëmtuar si pasojë e fatkeqësive natyrore dhe emergjencave civile, me qëllim rikthimin e funksionalitetit të objekteve dhe garantimin e sigurisë së qytetarëve.

Pas verifikimeve në terren dhe vlerësimit të nevojave prioritare, propozohet që fondi të shpërndahet sipas këtyre objekteve:

1-Mbrojtje Lumore në luginën e Gribës me vlerën 4.000.000 lekë me TVSH.

2-Ndërhyrje me tombina në përroin e Shelcanit dhe perroin e Frashërit me vlerën 1.200.000 lekë me TVSH.

3-Rikonstruksion i urës në segmentin rrugor Dufshan-Sult me vlerën 1.100.000 lekë me TVSH.

4-Rikonstruksion i urës në fshatin Galigat me vlerën 1.200.000 lekë me TVSH.

5-Rikonstruksion i urës në Dumberas me vlerën 1.200.000 lekë me TVSH.

Adresa:Sheshi"Kamber Dermyshi" Bulevard"10 Korriku" Tel.Fax:0513 2 2272 Email:bashkia.gramsh@bashkiagramsh.gov.al

6-Rikonstruksion i dy urave të këmbësorëve në fshatin Kukur me vlerën 600.000 lekë me TVSH.

Për sa më sipër, lutemi për miratimin e këtaj mënyre përdorimi të Fondit të Mbrojtjes Civile,me qëllim realizimin e ndërhyrjeve prioritare në objektet infrastrukturore të Bashkisë Gramsh.

**Ju ftoj**, të nderuar këshilltarë, që pas shqyrtimit nga ana Juaj, të miratoni projektvendimin e propozuar.

Duke Ju falenderuar ,

**M I R A T O H E T**

P/Sektori

**Ejona BLLOSHMI**

**KRYETARI**

**Besion AJAZI**

REPUBLIKA E SHQIPERISE - BASHKIA GRAMSH

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA GRAMSH**
**KRYETARI I KËSHILLIT**

Nr.3649/1 Prot Gramsh më 22.07.2026

**PROJEKT – VENDIM**

**PËR**

**"Për ndarjen e fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për Mbrojtjen Civile, për bashkinë Gramsh, për vitin 2026".**

Në mbështetje të: ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"; nenit 65 të ligjit 45/2019 "Për mbrojtjen civile", VKM nr. 414 datë 8.7.2021 "Për miratimin e proçedurave dhe kritereve për përdorimin dhe shpërndarjen e fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për Mbrojtjen Civile"; VKB Nr. 105 datë 29.12.2025 "Për miratimin e programit buxhetor të Bashkisë Gramsh, për vitin 2026" si edhe pasi shqyrtoi relacionin dhe dokumentacionin e paraqitur nga Sektori i Emergjencave Civile dhe Strehimit;

**VENDOSI:**

**1.**Miratimin e shpërndarjes së fondit të kushtëzuar në shumën 9,342,128 (nëntë milion e treqind e dyzet e dy mijë e njëqind e njëzet e tetë) lekë, me kod produkti 21AD502 "Rehabilitimi i objekteve të ndryshme infrastrukturore", akorduar nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, si më poshtë

-Mbrojtje Lumore në luginën e Gribës me vlerën 4.000.000 lekë me TVSH.

-Ndërhyrje me tombina në përroin e Shelcanit dhe perroin e Frashërit me vlerën 1.200.000 lekë me TVSH.

-Rikonstruksion i urës në segmentin rrugor Dufshan-Sult me vlerën 1.100.000 lekë me TVSH.

-Rikonstruksion i urës në fshatin Galigat me vlerën 1.200.000 lekë me TVSH.

-Rikonstruksion i urës në Dumberas me vlerën 1.200.000 lekë me TVSH.

-Rikonstruksion i dy urave të këmbësorëve në fshatin Kukur me vlerën 600.000 lekë me TVSH.

**2**. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Mbrojtjes Civile, Sektori I Emergjencave Civile dhe Strehimit, si dhe Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse dhe Financës

**3**. Ky vendim Hyn në Fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**Sekretari i Këshillit të Bashkisë**

**Xhulia GJINI**

**KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK**

**Enis ZANI**

**REPUBLIKA E SHQIPERISË**
**KËSHILLI BASHKIAK GRAMSH**
**SEKRETARI I KËSHILLIT**

**Nr 3059 prot.** **Gramsh, më 22/07/2026**

## THIRRJE PËR MBLEDHJE

**Drejtuar :Komisioni i Sigurisë Publike, EmergjencaveCivile .**

**Për Dijeni: Drejtoria e Mbrojtjes Civile, Sektori i Emergjencave Civil dhe Strehimit.**

Ditën e Enjte datë 23 /07 /2026 ora 10:30 në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak, bazuar në Ligjin 139/2015 datë 17.12.2019 neni 54 gërma (a) neni 33 , neni 34 , neni 36 i Rregullores së Funksionimit të Këshillit të Bashkisë , zhvillohet mbledhja e komisionit për të diskutuar relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Mbrojtjes Civile, Sektori i Emergjencave Civil dhe Strehimit:

1- **Për miratimin e shpërndarjes së fondit të kushtëzuar për Emergjencat Civile në bashkinë Gramsh.**

**SEKRETAR I KËSHILLIT BASHKIAK**

**XHULIA GJINI**

Adresa: Sheshi "KamberDermyshi" Bulevardi "10 Korriku", E-mail:bashkia.gramsh@bashkiagramsh.gov.al

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA GRAMSH**
KRYETARI

Nr 3036 Prot                                                    Gramsh më 20 /07/2026

***RELACION***
***PËR***
**SHPËRNDARJEN E FONDIT TE PAKUSHTËZUAR SHTESË.**

Të nderuar këshilltarë!

Mbështetur në nenin 9 pika 1.3 shkronja “c”, 30, 41, 54 shkronja “dh” të ligjin 139/2015 datë 17.12.2015 “Për qeverisjen vendore”; kreu III nenet 10-20, kreu IV “nenett 22-29, kreu VII nenet 39-41 në ligjin Nr .68 /2017 datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjin Nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; ligjin Nr.10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”(i ndryshuar); udhëzimin nr 9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr. 2 datë 14.01.2026 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2026, VKB nr. 105 datë 29.12.2025 " Për miratimin e programit buxhetor për vitin 2026, Aktin Normativ Nr. 2 datë 06.07.2026 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 87/2025 “për buxhetin e vitit 2026” i ndryshuar

Në Aktin Normativ Nr. 2 datë 30.06.2026 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 87/2025 për buxhetin e vitit 2026” i ndryshuar Bashkisë Gramsh i është akorduar një grand shtesë prej 1,118,586 lekë, transfertë kjo shtesë e grandit të pakushtëzuar.

Sa më sipër propozojmë që grandi i mësipër të shpërndahet/përdoret për bonus qeraje financuar nga Bashkia Gramsh në shumën 1,118,586 lekë

Faleminderit.

**Drejtori Ekonomik**
**Ermal Hysa**

**Kryetari i Bashkise**
**Besion Ajazi**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA GRAMSH

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**KËSHILLI BASHKIAK**
**GRAMSH**

Nr 3036 prot                                        Gramsh 20 /07/2026

**P / V E N D I M**

Nr      dt.      .      .2026

**PËR**
**SHPËRNDARJEN E FONDIT TE PAKUSHTËZUAR SHTESË.**

Këshilli i Bashkisë Gramsh, në mbledhjen e tij të datës __.07.2026 , pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëset "Për shpërndarjen e fondit të pakushtëzuar shtesë", mbështetur në nenin 9 pika 1.3 shkronja "c", 30, 41, 54 shkronja "dh" të ligjin 139/2015 datë 17.12.2015 "Për qeverisjen vendore"; kreu III nenet 10-20, kreu IV "nenett 22-29, kreu VII nenet 39-41 në ligjin Nr .68 /2017 datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", ligjin Nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar; ligjin Nr.10 296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"(i ndryshuar); udhëzimin nr 9 datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr. 2 datë 14.01.2026 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2026, VKB nr. 105 datë 29.12.2025 " Për miratimin e programit buxhetor për vitin 2026, Aktin Normativ Nr. 2 datë 06.07.2026 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 87/2025 "për buxhetin e vitit 2026" i ndryshuar.

**V E N D O S I**

**I.**Të përdoret Fondi i pakushtëzuar shtresë sipas Aktrit Normativ Nr 2 datë 30.10.2026 në shumën 1,118,586 lekë e ndarë si më poshtë:

1. Të përdoren për bonus qeraje financuar nga Bashkia Gramsh në shumën 1,118,586 lekë.

**II.** Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria e Financës dhe Buxhetit.

**III.** Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**Sekretari i Keshillit**
**Xhulia Gjini**

**Kryetari i Këshillit Bashkiak**
**Enis Zani**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KESHILLI BASHKIAK
GRAMSH

Nr.3854 Prot                                        Gramsh më 20/07/2026

**PROJEKT-VENDIM**
**Nr ____ Date ___/___/2026**

**PËR**
**DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE PER MUAJIN QERSHOR 2026 (FONDI 6%)**

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës ___/___/ 2026,pasi mori në shqyrtim projekt-vendimin e Drejtorisë së Shërbimeve dhe Mbrojtjes Sociale,Sektori i Ndihmës Ekonomike dhe Aftësisë së Kufizuar " Për dhënien e ndihmës Ekonomike nga fondi 6% për muajin **qershor2026**" mbeshtetur në Ligjin Nr 57 dt 18.07.2019 "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë,Neni 21;*VKM Nr.597 datë 04.09.2019 si dhe në* Ligjin Nr. 139/2015 datë 17.12.2015 "Për veteqeverisjen vendore"neni 8,pika 2;neni 9 ,pika 1.1/a dhe 1.1/b si dhe neni 54 pika ( k) dhe (n);

**VENDOSI:**

1 **Të përfitojnë Ndihmë Ekonomike 38 familje me një fond prej 174.519 lekë sipas tabelës së mëposhtme:**

| Njësia administrative | Nr | Emri i Aplikantit | NID | Nr Aplikimit | Statusi aplikimit | Vlera e llogaritur për fondin 6% | Kompensimi i Energjisë | Totali | Nr anëtarëve |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Gramsh | 1 | Qazime Rustem Meta | G05725070E | NE-2021-024062 | Rekomanduar per trajtim me fondin 6 % | 2178.00 | 1288.00 | 3466.00 | 2 |
| | 2 | Bujar Ali Qyra | H10123023D | NE-2024-021807 | Rekomanduar per trajtim me fondin 6 % | 0.00 | 1288.00 | 1288.00 | 1 |
| | 3 | Leonora Zahmeti Dragoti | H75416201B | NE-2024-024807 | Rekomanduar per trajtim me fondin 6 % | 2178.00 | 1288.00 | 3466.00 | 2 |
| | 4 | Fiqirete Pellumb Vela | G76227112Q | NE-2025-005392 | Rekomanduar per trajtim me fondin 6 % | 2178.00 | | 2178.00 | 1 |
| | 5 | Rudina Veli Huta | I55910079O | NE-2025-008967 | Rekomanduar per trajtim me fondin 6 % | 7920.00 | | 7920.00 | 3 |
| | 6 | Izaura Artur Dulja | I75626114L | NE-2025-014765 | Rekomanduar per trajtim me fondin 6 % | 5940.00 | | 5940.00 | 2 |
| | 7 | Alma Muharrem Brahimi | H35108049C | NE-2025-016679 | Rekomanduar per trajtim me fondin 6 % | 2178.00 | | 2178.00 | 1 |
| | 8 | Arta Ramazan Latollari | H15107044B | NE-2025-019718 | Rekomanduar per trajtim me fondin 6 % | 3703.00 | 1288.00 | 4991.00 | 2 |
| | 9 | Besjana Kujtim Hoxha | J15606107P | NE-2025-019723 | Rekomanduar per trajtim me fondin 6 % | 2178.00 | | 2178.00 | 1 |
| | 10 | Roland Faik Rrengo | H41125140O | NE-2025-023427 | Rekomanduar per trajtim me fondin 6 % | 2178.00 | | 2178.00 | 1 |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 11 | Greta Skënder Çela | J06120014C | NE-2025-024940 | Rekomanduar per trajtim me fondin 6 % | 5940.00 | | 5940.00 | 2 |
| | 12 | Ezmira Abedin Kasmi | I75904026T | NE-2026-000250 | Rekomanduar per trajtim me fondin 6 % | 12672.00 | | 12672.00 | 5 |
| | 13 | Flora Shyqo Haxhia | G65407150A | NE-2026-000925 | Rekomanduar per trajtim me fondin 6 % | 3146.00 | | 3146.00 | 1 |
| | 14 | Dritan Shefit Berdellima | H00107065M | NE-2026-005926 | Rekomanduar per trajtim me fondin 6 % | 2178.00 | | 2178.00 | 1 |
| | 15 | Eliana Besim Leshi | J15529097A | NE-2026-008523 | Rekomanduar per trajtim me fondin 6 % | 6732.00 | | 6732.00 | 4 |
| | 15 | **Total Njësia Administrative: Gramsh** | | | | 61299.00 | 5152.00 | 66451.00 | 29 |
| Kodovjat | 1 | Fiqiri Nazif Dhëmbi | H40317016W | NE-2025-010122 | Rekomanduar per trajtim me fondin 6 % | 6752.00 | 1288.00 | 8040.00 | 4 |
| | 1 | **Total Njësia Administrative: Kodovjat** | | | | 6752.00 | 1288.00 | 8040.00 | 4 |
| Kushove | 1 | Naxhire Selim Bora | H15405044A | NE-2023-014161 | Rekomanduar per trajtim me fondin 6 % | 2178.00 | | 2178.00 | 1 |
| | 2 | Rajmonda Ramadan Kapllani | H05607077O | NE-2023-014787 | Rekomanduar per trajtim me fondin 6 % | 2178.00 | | 2178.00 | 1 |
| | 3 | Thoma Xhaferr Bora | G91012048I | NE-2025-022133 | Rekomanduar per trajtim me fondin 6 % | 5227.00 | 1288.00 | 6515.00 | 3 |
| | 3 | **Total Njësia Administrative: Kushove** | | | | 9583.00 | 1288.00 | 10871.00 | 5 |
| Pishaj | 1 | Nuri Myftar Kotorri | F70116003E | NE-2018-007419 | Rekomanduar per trajtim me fondin 6 % | 3703.00 | 1288.00 | 4991.00 | 2 |
| | 2 | Naxhije Mustafa Çela | G55209131P | NE-2024-021348 | Rekomanduar per trajtim me fondin 6 % | 3146.00 | | 3146.00 | 1 |
| | 3 | Ramazane Rexhep Ahmati | F85605013F | NE-2024-022412 | Rekomanduar per trajtim me fondin 6 % | 3146.00 | | 3146.00 | 1 |
| | 4 | Lirije Banush Mesiti | G45505047G | NE-2025-001690 | Rekomanduar per trajtim me fondin 6 % | 3146.00 | 1288.00 | 4434.00 | 1 |
| | 5 | Shpresa Luman Kovaçi | F95712015O | NE-2025-014973 | Rekomanduar per trajtim me fondin 6 % | 3146.00 | 1288.00 | 4434.00 | 1 |
| | 6 | Drita Kasem Kula | G65404201E | NE-2025-015194 | Rekomanduar per trajtim me fondin 6 % | 3146.00 | 1288.00 | 4434.00 | 1 |
| | 7 | Ervin Ali Paja | I90903018P | NE-2025-021004 | Rekomanduar per trajtim me fondin 6 % | 8712.00 | | 8712.00 | 5 |
| | 8 | Flora Muharrem Shurdha | G65125048M | NE-2025-024935 | Rekomanduar per trajtim me fondin 6 % | 3146.00 | 1288.00 | 4434.00 | 1 |
| | 8 | **Total Njësia Administrative: Pishaj** | | | | 31291.00 | 6440.00 | 37731.00 | 13 |
| Sult | 1 | Abedin Dule Miraka | F81021007P | NE-2017-058523 | Rekomanduar per trajtim me fondin 6 % | 3703.00 | 1288.00 | 4991.00 | 3 |
| | 2 | Nefail Refit Verça | G40920013H | NE-2022-021711 | Rekomanduar per trajtim me fondin 6 % | 3049.00 | 1288.00 | 4337.00 | 3 |
| | 3 | Fatushe Osman Jança | F45522018I | NE-2025-017667 | Rekomanduar per trajtim me fondin 6 % | 3049.00 | | 3049.00 | 2 |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 4 | Haki Hysen Dermyshi | F70220047S | NE-2025-025098 | Rekomanduar per trajtim me fondin 6 % | 3703.00 | 1288.00 | 4991.00 | 2 |
| | 4 | **Total Njësia Administrative: Sult** | | | | 13504.00 | 3864.00 | 17368.00 | 10 |
| Tunje | 1 | Leonard Barjam Miraka | I40830016L | NE-2023-016345 | Rekomanduar per trajtim me fondin 6 % | 5881.00 | | 5881.00 | 4 |
| | 2 | Resmije File Murati | F76031002L | NE-2024-011999 | Rekomanduar per trajtim me fondin 6 % | 3146.00 | 1288.00 | 4434.00 | 1 |
| | 3 | Çaush Feta Hoxha | G90620031B | NE-2024-015424 | Rekomanduar per trajtim me fondin 6 % | 2178.00 | 1288.00 | 3466.00 | 2 |
| | 4 | Hysen Barjam Barçi | G20212034M | NE-2024-015576 | Rekomanduar per trajtim me fondin 6 % | 3703.00 | 1288.00 | 4991.00 | 2 |
| | 5 | Xhevair Mehdi Tabaku | F20824006P | NE-2024-016503 | Rekomanduar per trajtim me fondin 6 % | 3049.00 | 1288.00 | 4337.00 | 3 |
| | 6 | Dritan Riza Miraka | H20330016Q | NE-2024-016640 | Rekomanduar per trajtim me fondin 6 % | 5227.00 | 1288.00 | 6515.00 | 3 |
| | 7 | Hava Tahir Salla | F85129033J | NE-2025-021481 | Rekomanduar per trajtim me fondin 6 % | 3146.00 | 1288.00 | 4434.00 | 1 |
| | 7 | **Total Njësia Administrative: Tunje** | | | | 26330.00 | 7728.00 | 34058.00 | 16 |
| **Total Bashkia: Gramsh** | 38 | | | | | 148759.00 | 25760.00 | 174519.00 | 77 |
| | 38 | | | | | 148759.00 | 25760.00 | 174519.00 | 77 |

**Dr.Drej.Shërbimeve dhe Mbrojtjes Sociale**
**Elisabeta Xhepexhiu**

**Dr.Drej. Finances dhe Buxhetit**
**Ermal Hysa**

**Sekretari Keshillit**
**Xhulia Gjini**

**Kryetari Keshillit**
**Enis Zani**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA GRAMSH**
**DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE E KONTROLLIT TË TERRITORIT, MJEDISIT DHE PRONËS**
**SEKTORI I ADMINISTRIMIT TË PRONAVE PUBLIKE**

Nr 3032 Prot. Gramsh, më 20 / 07 /2026

# RELACION

**PËR KALIMIN NË FOND BANESE TË OBJEKTIT "ISH NDËRMARRJA E SHQOPAVE" PASURIA NR. 7/97 ZONA KADASTRALE 1842, NË PRONËSI TË BASHKISË GRAMSH, PËR QËLLIME STREHIMI DHE PRIVATIZIMI.**

**Të nderuar Këshilltarë!**

**Baza ligjore.**

Referuar VKM-së nr. 431 datë 11.07.2007,"Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Gramsh, të qarkut të Elbasanit", sipas VKM-së "Ish Ndërmarja e Shqopave", ka kaluar në pronësi të Bashkisë Gramsh dhe është çertifikuar.

Në rastet kur organet e qeverisjes vendore marrin vendim për kalimin e pronësisë së këtyre objekteve, subjekteve private, të proçedohet në përputhje me legjislacionin në fuqi mbështetur në Ligjin nr. 22, datë 03.05.2018, "Për Strehimin Social" si dhe për vlerësimin e pronës referuar Vendimit të Këshillit të Minstrave nr. 320, datë 06.05.2026 i ndryshuar "Për përcaktimin e proçedurave të privatizimit të banesave dhe objekteve të kthyera në fond banese."

Nisur nga fakti që ky objekt është amortizuar si dhe nga kërkesat e njëpasnjëshme të qyetarëve për privatizimin e tyre, kemi menduar që ta trajtojmë në Këshillin e Bashkisë për kalimin në fond banese dhe privatizimin e saj sipas kontratave respektive të qytetarëve. Në zbatim të Ligjit Nr. 139 datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 8 pika 2; neni 9 pika 1.2, paraqesim para Këshillit të Bashkisë Projekt-Vendimin përkatës duke ju sqaruar si më poshtë vijon :

**Përshkrimi i situates së objektit:**

Qytetarët të cilët banojnë në këtë objekt janë duke u pajisur me kontrata qiraje dhe duke qënë se objekti ka qënë i amortizuar, qytetarët i kanë kryer vetë investimet për ta përshtatur për strehim. Objekti ka vite që e ka humbur funksionin e tij dhe nuk shërben për asnjë funksion tjeter përveç strehimit.

Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 54, datë 05.02.2014 "Për përcaktimin e kritereve të proçedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore" nga mungesa e fondeve buxhetore për mirmbajtje apo për ndërhyrje për rikonstrusion, kemi lejuar të kryhen punime të objekteve të dhëna me qira për ta përshtatur sipas kontratës që ka lidhur me Bashkinë Gramsh për banim.

Për sa më sipër, me pëlqimin e qiradhënësit sipas dizpozitave të Kodit Civil neni 801 e vijues parashikon lejimin për riparime, përmiresimin e objektit të dhënë me qira të parashikuara edhe në kontratë për ta bërë atë të përshtatshme për banim.

Këshilli i Bashkisë ka autoritetin të vendosë përcaktimin destinacionin e përdorimit të këtyre objekteve, për t'i kthyer ato në fond banese dhe me qëllim privatizimin e tyre, referuar Vendimeve të Këshillit të Ministrave të sipërcituara.


Adresa: Sheshi "Kamber Dermyshi" Bulevardi "10 Korriku" Tel.Fax:0513 2 2272 E-mail: bashkia.gramsh@bashkiagramsh.gov.al

“Ish Ndërmarrja e Shqopave” është ndërtuar rreth viteve 60’, dhe që prej asaj kohe mungesa e investimeve me ndryshimet e sistemit të viteve 90 ka bërë që të amotizohet dhe ta humbasi funksionin e saj. Më pas ky objekt është kthyer në identitet dhe është riparuar nga vetë qytetarët që ta bëjnë të përshtatshëm për qëllim banimi.

Nisur nga Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer nga Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) të ushtruar në Bashkinë Gramsh për periudhen 01.01.2023 deri më 31.12.2024, me nr. 405/17 Prot. datë 21.10.2025 regjistruar me tonën nr. 4730 Prot. datë 24.10.2025 si dhe rekomandimet e lëna, para miratimit në Këshillin e Bashkisë, u ngrit komisioni me Urdhër të Kryetarit, nr. 135, datë 07.04.2026, i cili ka bërë matjet dhe verifikimet në terren për përgatitjen e dokumentacionit tekniko-ligjor për tjetrësimin e pronës.

Lista emërore e qytetareve që banojnë në këtë objekt, sipas verifikimeve në teren dhe kërkesave të tyre ndër vite janë si më poshtë:

**OBJEKTI ISH NDËRMARJA E SHQOPAVE**
**PASURIA NR 7/97 ME SIPËRFAQE TOTALE S-376 M², NDËRTESË-339.6 M²**
**EMËRTIMI: ISH NDËRMARJA E SHQOPAVE**

ME POSEDUES:
1.Valentina Dervishi me sip. 29.8m
2.Burbuqe Latifi me sip.44.6m$^2$
3.Besim Taragjini me sip.95m$^2$
4.Muke Tafa me sip. 81.7m$^2$
5.Nefail Tafa me sip. 82.2m$^2$
6.Xhile Veliu me sip. 42.6m$^2$

Sa më sipër i propozojmë Këshillit të Bashkisë të miratojë Relacionin dhe P/Vendimin e paraqitur nga Drejtoria e Planifikimit dhe e Kontrollit të Territorit, Mjedisit dhe Pronës, Sektori i Administrimit të Pronave Publike, Bashkia Gramsh .

Bashkëlidhur një kopje të dokumentacionit .
1.Çertifikata e regjistrimit të pronësisë.
2.Kartela e Pasurisë së Paluajtshme.
3.Fragmenti i Hartës Kadastrale.
4.Planimetritë dhe Planvendosjet për secilin nga poseduesit

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin tuaj !

**KRYETARI I BASHKISË**

**Besion AJAZI**

REPUBLIKA E SHQIPERISE - BASHKIA GRAMSH



Adresa: Sheshi “Kamber Dermyshi” Bulevardi “10 Korriku” Tel.Fax:0513 2 2272 E-mail: bashkia.gramsh@bashkiagramsh.gov.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK
GRAMSH

Nr 3032/1 prot                                                  Gramsh, më 20/07/2026

# P/V E N D I M

**Nr.______datë,___/____/ 2026**

**P Ë R**
**KALIMIN NË FOND BANESE TË OBJEKTIT "ISH NDËRMARRJA E SHQOPAVE" PASURIA NR. 7/97, NË PRONËSI TË BASHKISË GRAMSH, PËR QËLLIME STREHIMI DHE PRIVATIZIMI.**

Këshilli i Bashkisë Gramsh, në mbledhjen e tij të datës / /2026, pasi shqyrtoi materialet e paraqitura nga Drejtoria e Planifikimit dhe e Kontrollit të Territorit, Mjedisit dhe Pronës, Sektori i Administrimit të Pronave Publike.
Bazuar në Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 431, datë 11.12.2007, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Gramsh, të qarkut të Elbasanit", dhe sipas VKM-së "Ish Ndërmarja e Shqopave", ka kaluar në pronësi të Bashkisë Gramsh dhe është çertifikuar.
Mbështetur në Ligjin nr. 22, datë 03.05.2018, "Për Strehimin Social" si dhe për vlerësimin e pronës referuar Vendimit të Këshillit të Minstrave nr. 320, datë 06.05.2026 i ndryshuar "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 179, datë 26.02.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për rregullat, kushtet dhe procedurat e privatizimit të banesave, që kanë qënë subjekt i ligjit nr.7652, datë 23.12.1992, "Për privatizimin e banesave shtetërore", dhe të ligjit nr. 9321, datë 25.11.2004, "Për privatizimin e banesave dhe objekteve të kthyera në banesa, të ndërtuara me fondet e shoqërive dhe ndërmarrjeve shtetërore"", të ndryshuar.
Në zbatim të Ligjit Nr. 139 datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 8 pika 2; neni 9 pika 1.2, me propozimin të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë

**V E N D O S I:**

1. Kthimin në fond banese të objektit **"Ish Ndërmarrja e Shqopave"**, në pronësi të bashkisë Gramsh, ndarjen dhe çertifikimin e çdo njësie banimi sipas listës së miratuar të banoreve që banojnë në to duke specifikikuar dhe siperfaqet respektive të tyre.

2. Nisjen e proçedurave të privatizimit të familjareve që banojnë si më poshtë:

**LISTA EMERORE E OBJEKTEVE TË DHËNA ME QIRA**
**OBJEKTI NR.1**
**PASURIA NR 7/97 ME SIPËRFAQE TOTALE S-376 M² DHE SIP. NDËRTESE S-339.6 M².**
**EMËRTIMI: ISH NDËRMARRJA E SHQOPAVE.**

ME POSEDUES:
1.Valentina Dervishi me sip. 29.8m
2.Burbuqe Latifi me sip.44.6m$^2$


Adresa: Sheshi "Kamber Dermyshi" Bulevardi "10 Korriku" Tel.Fax:0513 2 2272 E-mail: bashkia.gramsh@bashkiagramsh.gov.al

3.Besim Taragjini me sip.95$m^2$
4.Muke Tafa me sip. 81.7$m^2$
5.Nefail Tafa me sip. 82.2$m^2$
6.Xhile Veliu me sip. 42.6$m^2$

3. Vlersimi i pronës të llogaritet sipas Vendimit të Këshillit të Minstrave Nr. 320, datë 06.05.2026 i ndryshuar.

4. Në përfundim të procedurës të lidhen kontratat e shitjes para noterit midis qytetarëve të mësipërm në cilësinë e blerësit dhe Bashkisë Gramsh në cilësin e shitësit i përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë ose personi i autorizuar prej tij.

5.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë dhe Komisioni i Privatizimit të banesave pronë e bashkisë.

6. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit të tij nga institucioni i Prefektit të Qarkut Elbasan

**SEKRETARI I KËSHILLIT**

**Xhulia GJINI**

**KRYETARI I KËSHILLIT**

**Enis ZANI**



Adresa: Sheshi "Kamber Dermyshi" Bulevardi "10 Korriku" Tel.Fax:0513 2 2272 E-mail: bashkia.gramsh@bashkiagramsh.gov.al

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA GRAMSH**
**KRYETARI**

Nr3031 Prot                                                                                     Gramsh, më 20.07.2026

Lënda: Propozim zyrtar, për vendosjen e emrit Xhevit Dermyshi "Shkollës 9-vjeçare "35 Vjetori i Çlirimit", Gramsh

**KËSHILLIT BASHKIAK GRAMSH**

**Të nderuar anëtarë të Këshillit Bashkiak!**

Në mbështetje të kompetencave të Bashkisë në fushën e infrastrukturës arsimore, ruajtjes së kujtesës qytetare dhe promovimit të identitetit lokal, paraqes për shqyrtim propozimin për emërtimin e "Shkollës 9-vjeçare 35 Vjetori i Çlirimit", Gramsh, me emrin "Shkolla 9-vjeçare Xhevit Dermyshi".

Ky propozim paraqitet në vlerësim të figurës dhe kontributit të z. Xhevit Dermyshi, një prej personaliteteve të respektuara të arsimit në Gramsh. Gjatë veprimtarisë së tij shumëvjeçare, ai ka shërbyer si mësues matematike, drejtues i strukturave arsimore, drejtor shkolle dhe këshillues pedagogjik, duke dhënë një ndihmesë të çmuar në formimin e brezave dhe në zhvillimin e arsimit lokal.

Në respekt të figurës së ndjerë të z. Xhevit Dermyshi, një intelektual dhe kontribuues i shquar në fushën e arsimit dhe të formimit të brezave në qytetin e Gramshit, propozoj që "Shkolla 9-Vjeçare 35 Vjetori i Çlirimit" të mbajë emrin "Shkolla 9-vjeçare Xhevit Dermyshi", në nder të jetës, veprës dhe përkushtimit të tij të rrallë për edukimin dhe zhvillimin arsimor të komunitetit tonë.

Z. Xhevit Dermyshi ka qenë një ndër figurat më të respektuara të arsimit në Gramsh, i njohur për përkushtimin, profesionalizmin dhe ndikimin e tij të ndjeshëm në edukimin e brezave.
Ai u diplomua në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës, në degën Matematikë, si dhe përfundoi studimet e dyta në Fakultetin e Histori-Filologjisë, në degën Pedagogji-Psikologji. Mbajti titullin "Mjeshtër i Asociuar në Psikologji Edukimi", duke e pasuruar arsimin e qytetit me qasje bashkëkohore pedagogjike.

Në karrierën e tij shumëvjeçare, zoti Dermyshi ka mbajtur detyra të rëndësishme dhe me ndikim të drejtpërdrejtë në arsimin e Gramshit:

- 1979 – Mësues matematike
- 1985 – Përgjegjës i Seksionit të Arsimit të Rrethit Gramsh
- 1988 – Drejtor i Kabinetit Pedagogjik

Adresa: Sheshi "Kamber Dermyshi" Bulevardi "10 Korriku" E-mail: bashkia.gramsh@bashkiagramsh.gov.al

- 1993 – Drejtor i Gjimnazit “Shefqet Guzi”
- 2004 – Përgjegjës i Sektorit të Këshillimit Pedagogjik në Zyrën Arsimore
- 2015 – Përgjegjës i Sektorit të Arsimit të Rrethit Gramsh

Përveç angazhimit në arsim, z. Dermyshi ka dhënë kontribut edhe në jetën publike të qytetit, duke shërbyer si anëtar i Këshillit Bashkiak të Gramshit në katër legjislatura. Vlerësimet e marra nga institucionet arsimore dhe botimet e tij në fushën e edukimit dëshmojnë për përkushtimin e vazhdueshëm ndaj mësimdhënies, pedagogjisë dhe komunitetit.

Kontributet e tij janë vlerësuar edhe nga institucionet kombëtare:
- Certifikatë mirënjohjeje nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës “Për përkushtim në arsim e edukim”.
- Certifikatë vlerësimi si trajner lokal për hartimin e planeve vjetore të shkollës.

Në fushën e publicistikës, ai ka botuar artikuj e analiza në Gazetën “Mësuesi”, Revistën Pedagogjike, Gazetën “Shpresa”, Revistën “Pajtimi” dhe gazetën e shkollës “Ne”. Është autor i dy botimeve me vlerë për edukimin: “Rritje Shpirtërore” dhe “Ne dhe Kompjuteri”.

Vendosja e emrit të tij në një institucion arsimor do të përbënte një nderim të merituar dhe një vlerë të qëndrueshme për komunitetin e Gramshit. Emërtimi synon të ruajë kujtesën e kontributit të tij dhe të ofrojë një shembull frymëzues për nxënësit, mësuesit dhe prindërit.

Ky akt do të përfaqësonte një mirënjohje të denjë për një personalitet që i ka përkushtuar jetën e tij për arsimin, edukimin dhe përparimin e qytetit tonë.

Duke qenë se përcaktimi i procedurës së posaçme për riemërtimin e një institucioni arsimor publik kërkon koordinim me autoritetin përgjegjës për arsimin parauniversitar, propozohet që Këshilli Bashkiak të shprehë dakordësinë për këtë emërtim dhe të autorizojë ndjekjen e procedurave përkatëse pranë autoritetit kompetent. Zbatimi i emrit të ri në tabelat, regjistrat dhe dokumentacionin zyrtar do të kryhet vetëm pas përfundimit të procedurës ligjore përkatëse.
Këtij propozimi i bashkëlidhet dokumentacion me nderime e certifikatat të të ndjerit z. Xhevit Dermyshi.

Me konsideratë,

**KRYETARI**

**BESION AJAZI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA GRAMSH



BARI

PASAPORTË REPUBLIKA E SHQIPËRISË REPUBLIC OF ALBANIA

PASSPORT

P ALB BG4613395

Dermyshi

Xhevit

Shqiptare/Albanian

11-10-1954

M

Zgjupe,Gramsh

25-02-2011

24-02-2021

MB

F41011024U

ALB

P<ALBDERMYSHI<<XHEVIT<<<<<<<<<<<<<<<<

BG46133950ALB5410112M2102241F4101102



## CURRICULUM VITAE

1. **Xhevit Bedri Dermyshi**

2. Datëlindja dhe vendlindja: 11.10.1954, Gramsh.

3. Arsimimi: Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës, dega **Matematikë**, nota mesatare 8.6

4. Specializime:

   a. Kurs Pasuniversitar, Fakulteti Histori-Filologji të UT, Diplomë në **Pedagogji-Psikologji,** notë mesatare 10.

   b. Master Profesional në UE, "**Psikolog Institucioni**".

   c. Titull MSC "**Mjeshtër i asociuar në psikologji edukimi**" në UE me nr. 174, datë 08.09.2015.

5. Specializim në kompjuter:

   a. Në vitin 1992 pranë **INIMA**, Tiranë.

   b. Në vitin 1998 kurs një mujor për Informatikë, organizuar nga MASH dhe Ambasada Amerikane në Qëndrën Profesionale "**Abraham Linkoln Foundation**" me vlerësim "Shumë mirë".

6. Provime Pasuniversitare:

   A. Të specialitetit:

   a. **Pedagogji e përgjithshme**, nota 10.

   b. **Psikologji e personalitetit**, nota 10.

   B. Të përgjithshme:

   a. **Filozofi**, nota 7, (dëshmi)

   C. Gjuhë të huaja:

   a. **Rusisht**, viti 1985, nota 8, (dëshmi)

   b. **Italisht**, viti 1998, nota 9, (dëshmi)

   D. Trajnime në fushën e edukimit:

   a. Çertifikatë Mirënjohje nga MASH, "**Si mësues i përkushtuar në arsim dhe dukim**".

   b. Çertifikatë Vlerësimi "**Trajner Kombëtar ne Edukim**".

   c. Çertifikatë Vlerësimi "**Trajner lokal për planin vjetor të shkollës**".

   d. Çertifikatë Vlerësimi "**Trajner lokal për planifikimin e orëve të lira**".

7. Eksperiencë pune:

   a. **Mësues matematike** në shkollën 8-vjeçare "Dervish Miraka" në Sult për një periudhë 6-vjeçare.

   b. **Specialist i matematikës (metodist)** në Kabinetin Pedagogjik të rrethit, për një periudhë 8-vjeçare.

c. **Përgjegjës i seksionit të Arsimit të rrethit Gramsh**, në vitet 1985-1987 dhe 1990-1992.

d. **Drejtor i Kabinetit Pedagogjik të rrethit**, në vitet 1988-1990.

e. **Mësues dhe Drejtor i shkollës së mesme** "Shefqet Guzi", në vitet 1993-1994 deri më 2003-2004.

ë. **Përgjegjës i Sektorit të Këshillimit Pedagogjik** pranë ZA, në vitet 2004-2010.

f. **Përgjegjës i Sektorit të IT e Statistikës** pranë ZA, në vitet 2010-2017.

g. **Përgjegjës i Zyrës Arsimore Gramsh**, në vitet 2017-2020.

8. Angazhime në grupe pune dhe botime:

a. Pjesëmarrje ne disa grupe kontrolli nga **Ministria e Arsimit**, në vitet 1984-1990.

b. Pjesëtar il grupit të punës pranë **ISP** për ksperimentin e matematikës për shkollat 8-vjeçare.

c. Botime të shkrimeve të ndryshme me karakter metodik, pedagogjik e psikologjik në **gazetën "Mësuesi"** dhe **Revistën Pedagogjike**.

d. Botime të shkrimeve të ndryshme me karakter të përgjithshëm social-kulturor në **gazetën "Shpresa", ne Revistën "Pajtimi", në një botim special për Gramshin në 50-vjetorin e tij, në gazetën e shkollës "Ne", në gazetën "Intervista" etj.**

e. Drejtues i shkolles "Shefqet Guzi" **në zbatimin e Eksperimentit Për Profilizimin e arsimit të mesëm**, në vitin shkollor 1999-2000 deri në vitin 2003-2004.

ë. Angazhim në zbatimin e kurrikulës së re të gjimnazit, **në zbatimin e Altertekstit dhe Maturës Shtetërore.**

9. Botime:

a. "**Rritje Shpirtërore**", botim Social-Psikologjik, Shkurt 2004.

b. "**Ne dhe kompjuteri**", botim Metodologjik-Shkencor, Mars 2005.

c. "**Pema e jetës**", me bashkëautor.

d. "**Lizeci dhe Skënder Lena**", Maj 2019.

10. Pjesëmarrje në OJF dhe trajnime të ndryshme:

a. **Kryetar i Forumit të Organizatave Jofitimprurëse (OJF)**, Gramsh.

b. **Kryetar i Shoqatës së Intelektualëve "Progress"**, Gramsh.

c. **Drejtues Bordi i Shoqatës "Ajzberg"** si edhe **të Qëndrës për Shëndetin Mendor**, I ngritur me kujdesjen dhe financimin e Organizatës Botërore të Shëndetësisë. Trajnuar si psikolog i kësaj qëndre ne Çeki, Itali, etj.

d. **Ekspert-psikolog pranë Gjykatës së rrethit Gramsh**, në vitet 2005-2010.

11. I zgjedhur:



## XHEVIT DËRMYSHI

Ka lindur në Gramsh në vitin 1954.

Është diplomuar në vitin 1978 për matematikë në Universitetin e Tiranës. Në vitin 1984-1986 ka kryer specializimin pasuniversitar për pedagogji-psikologji në Fakultetin e Filologjisë në UT.

Në vitin 1992 dhe 1998 ka kryer kursin për informatikë në INIMA dhe "Abraham Linkoln", Tiranë.

Është autor i librit social-psikologjik "Rritje shpirtërore" dhe i shumë shkrimeve Revistën Pedagogjike, gazetat "Mësuesi", "Shpresa" etj.

Çmimi 700 lekë

XHEVIT DËRMYSHI



# Në dhe kompjuteri

"Shpresa"



## Xhevit DERMYSHI

U lind në Gramsh më 1954.

Veprimtarinë mësimore, pedagogjike e shoqërore e ka filluar në vitin 1978, pas diplomimit për matematikë në Fakultetin të Shkencave të Natyrës të Universitetit të Tiranës. Ka punuar si mësues në arsimin parauniversitar në vitet 1978 – 1983 dhe më tej si metodist, drejtor i Kabinetit Pedagogjik dhe përgjegjës i Seksionit të Arsimit dhe Kulturës në vitet 1983 –1993.

Në vitin 1984 – 1986 ka kryer specializimin pasuniversitar për pedagogji–psikologji pranë Fakultetit të Histori - Filologjisë, në Universitetin e Tiranës. Në vitin 1992 dhe 1998 ka kryer kursin për Informatikë pranë INIMA dhe "Abraham Linkoln" Tiranë. Nga viti 1995 është drejtor i shkollës së mesme të përgjithshme "Shefqet Guzi", Gramsh.

Ka botuar shkrime në Revistën Pedagogjike, gazetën "Mësuesi", gazetën lokale "Shpresa" etj.

Këtë botim ia dhuron bashkëqytetarëve, krijuesve gramshiotë dhe publikut të gjerë.

Çmimi 400 Lekë

# XHEVIT DERMYSHI

# RRITJE SHPIRTËRORE




### Shënime social - psikologjike

XHEVIT DERMYSHI



* I lindur në Gramsh.
* Diplomuar në Universitetin e Tiranës
për matematikë dhe pedagogji - psikologji.
* Veprimtarinë mësimore, pedagogjike dhe
shoqërore e zhvillon në Gramsh.
*Është nderuar me titullin "Qytetar Nderi"
i Bashkisë Gramsh.
*Ka botuar librat:
-Rritje shpirtërore,
-Matematika argëtuese,
-Ne dhe kompjuteri,
si dhe shkrime të ndryshme në
Revistën Pedagogjike, "Pajtimi",
në gazetën "Mësuesi", "Shpresa" etj.
Këtë botim ia dhuron familjes së Skënder Lenës



Qendra e qytetit të Gramshit

ISBN 978-9928-273-13-0

Xhevit Dermyshi   Liseci dhe Skënder Lena

# XHEVIT DERMYSHI



# Liseci dhe Skënder Lena

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR KORÇË
ZYRA VENDORE ARSIMORE GRAMSH
SHKOLLA E MESME E BASHKUAR "ÇAUSH SENIA" TUNJË

# Certifikatë Mirënjohje

## 100 VJET ARSIM NË TUNJË

**I jepet Z XHEVIT DERMYSHI**

*"Për arritje në veprimtaritë e zhvilluara për edukimin atdhetar, qytetar dhe kulturor të nxënësve, në ruajtjen dhe pasurimin e traditës dhe vlerave të krijuara me punë ndër vite".*

*Tunjë më, 29.10. 2021*

**DREJTORI**
**LOREN KOKOMECI**

REPUBLIKA E SHQIPERISË

BASHKIA GRAMSH

SHKOLLA E MESME
"SHEFQET GUZI"



# ÇERTIFIKATË MIRËNJOHJEJE

*I jepet* **Xhevit Dermyshi**

*Me motivacionin* ***"Për punë të palodhur e të devotshme, si mësimdhënës dhe si edukatore të brezave të shumtë nxënësish, në shkollën e mesme "Shefqet Guzi"***

KRYETARI I BASHKISË
KASTRIOT ZERA

DREJTORE E SHKOLLËS SË MESME
VALBONA KONICA

*Gramsh, më 24.12.2010*

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS
Instituti i Kurrikulave dhe Trajnimit

# ÇERTIFIKATË VLERËSIMI

Z/Znj Xhevit Dermyshi

**Përfundoi kursin:**

**"Trajner lokal për planin vjetor të shkollës"**

Fitoi (2 /dy/ kredite)

**DREJTORI**
**Robert GJEDIA**

Tiranë, 2008

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS
Instituti i Kurrikulave dhe Trajnimit

Nr. Serisë A31
Nr. 32 Regj

# Certifikatë vlerësimi

Z. Xhevit Dyrmishi

Përfundoi kursin e parë
"Trajner në edukim"
Fitoi ( 8 ) kredite

DREJTORI
Robert Gjedia

Tiranë, dhjetor, 2008

THE WORLD BANK GROUP

MINISTRY OF EDUCATION AND SCIENCE

**This certificate is presented to**

XHEVIT DERMISHI

---

**for participation in**
**Procurement Seminar on "Education Excellence and Equity P rogram"**
**held in Durres - Albania, in December 14-15, 2006.**

---

*Naushad Khan*
*Lead Procurement Specialist*
*Europe and Central Asia Region*

*Antonieta LULI*
*Secretary General*
*Ministry of Education and Science*

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS

# Certifikatë

## MIRËNJOHJEJE

Z. /Znj. Xhevit Bedri Dërmyshi

Me propozim të Komisionit të Vlerësimit të Mësuesve dhe Drejtuesve të ngritur me rastin e festimit të 50-vjetorit të Shkollës së mesme "Shefqet Guzi", Gramsh:

I vlerësuar:

**"Mësues i përkushtuar në procesin mësimor-edukativ në vite"**

MINISTRI
Prof. Dr. MYQEREM TAFAJ

Tiranë më 24.12.2010

Save the Children

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
DREJTORIA ARSIMORE RAJONALE
ELBASAN

# ÇERTIFIKATË PJESËMARRJEJE

Z/Znj. XHEVIT DYRMISHI

*Ka marrë pjesë në trainimin 2 ditor me tematikë:*

*1. Njohuri bazë mbi trainimin e trainerëve*

*2. Metodologjitë ndërvepruese në klasë*

*organizuar nga DAR, QTKA dhe Save the Children.*

*Prill 2005*

*Stephen Ashby*
*Drejtor,*
*'Save the Children' Programi Shqiptar*

REPUBLIKA E SHQIPËRISË DREJTORIA ARSIMORE RAJONALE ELBASAN MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS

*Natasha Poroçani*
*Drejtore, DAR*
*Elbasan*

# FLETË NDERI

## I jepet mësuesit të dalluar

Z. XHEVIT BEDRI DERMYSHI

*Për punë shumë të mirë si mësimdhënës e edukator gjatë vitit 2004.*




Për Drejtorinë Arsimore

Sofie FEJZO

DREJTORE

Gramsh, 07.03.2004

Instituti i Studimeve Pedagogjike

IOM International Organization for Migration
ONM Organizata Ndërkombëtare për Migracionin

# ÇERTIFIKATË

I JEPET z. Xhevit DYRMISHI

Përfundoi me sukses kursin e trajnimit për parandalimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore nepërmjet shkollës, organizuar në datat 30 - 31 Maj dhe 10 – 11 Shtator 2003, nga Organizata Ndërkombëtare Për Migracionin (IOM), në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe me Institutin e Studimeve Pedagogjike.

Instituti i Studimeve Pedagogjike
Prof. Asoc. Dr. Marjana SINANI
N/Drejtore

IOM (Organizata Ndërkombëtare Për Migracionin)
Hera SHANAJ
Kordinatore Programi

**Mission in Albania:**
Rruga "Brigada e Tete", Vila no. 3 • Tirana • Albania
Tel: +355 42 57836 / 37, 40337 Fax: +355 42 57835 • E-mail: iomtirana@iomtirana.org.al
Internet: http://www.iomtirana.org.al

**Kombet e Bashkuara** **Thirrja e Hagës Për Paqe**

## Projekti i Edukimit Për Paqe dhe Çarmatim

Xhevit Dermyshi

*I Jepet Çertifikata për Pjesëmarrjen në*

**Shkollën e Verës**

**Zgjidhja dhe Transformimi i Konflikteve**

**Gramsh, Shtator 2003**

**Elton Skendaj, MA**
***Kordinator Kombëtar i Projektit***

Trainuesit e Fondacionit *Zgjidhje e Konflikteve dhe Pajtimi i Mosmarrëveshjeve*

| Albana Qatipi | Robert Gjedia | Astrit Dautaj |
| --- | --- | --- |

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA GRAMSH**
**AGJENCIA E FUNKSIONEVE TË PATRANSFERUESHME**
**DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE**

Nr 3031/1 Prot

Gramsh, më 20.07.2026

**RELACION**
**PËR**
**PROJEKT VENDIM**

**PËR**
**NDRYSHIMIN E EMËRTIMIT TË "SHKOLLËS 9-VJEÇARE "35 VJETORI I ÇLIRIMIT" ME EMRIN "SHKOLLA 9-VJEÇARE "XHEVIT DERMYSHI"**

**Të nderuar anëtarë të Këshillit Bashkiak!**

Në mbështetje të propozimit të Kryetarit të Bashkisë Gramsh, z. Besion Ajazi, si dhe në zbatim të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të Ligjit nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe akteve nënligjore në fuqi, paraqitet për shqyrtim projektvendimi për ndryshimin e emërtimit të **Shkollës 9-vjeçare "35 Vjetori i Çlirimit"** me emrin **"Shkolla 9-vjeçare "Xhevit Dermyshi""**.

Qëllimi i këtij projektvendimi është nderimi institucional i figurës së të ndjerit **Xhevit Dermyshi**, një prej personaliteteve më të spikatura të arsimit në Bashkinë Gramsh, i cili gjatë gjithë veprimtarisë së tij profesionale dha një kontribut të rëndësishëm në edukimin e brezave, drejtimin e institucioneve arsimore dhe zhvillimin e sistemit arsimor në territorin e bashkisë.

Nga dokumentacioni i paraqitur nga Kryetari i Bashkisë rezulton se z. Xhevit Dermyshi ka ushtruar për shumë vite funksione të rëndësishme në sistemin arsimor, ka qenë drejtues institucionesh arsimore, specialist i këshillimit pedagogjik dhe autor botimesh në fushën e edukimit. Veprimtaria e tij është vlerësuar me certifikata dhe mirënjohje nga institucionet arsimore, ndërsa kontributi i tij ka lënë gjurmë të qëndrueshme në jetën arsimore dhe qytetare të Gramshit.

Emërtimi i një institucioni arsimor me emrin e një personaliteti që ka kontribuar në mënyrë të shquar në arsim përbën një formë të ligjshme dhe të qëndrueshme të ruajtjes së kujtesës historike dhe institucionale të komunitetit. Ky veprim synon gjithashtu të promovojë modele pozitive për brezat e rinj, duke forcuar lidhjen e institucionit arsimor me historinë dhe vlerat e qytetit të Gramshit.

Projektvendimi nuk sjell pasoja financiare për buxhetin e Bashkisë Gramsh, përveç shpenzimeve minimale administrative që lidhen me përditësimin e tabelave identifikuese dhe dokumentacionit zyrtar, të cilat do të realizohen vetëm pas përfundimit të procedurave ligjore përkatëse.

Duke qenë se emërtimi i institucioneve arsimore publike kryhet sipas procedurave të përcaktuara në legjislacionin për arsimin parauniversitar, me këtë projektvendim propozohet që Këshilli Bashkiak të shprehë dakordësinë për emërtimin e ri dhe të autorizojë ndjekjen e procedurave pranë autoriteteve kompetente për miratimin përfundimtar.

Për sa më sipër, propozojmë që Këshilli Bashkiak Gramsh të shqyrtojë dhe të miratojë projektvendimin **"Për ndryshimin e emërtimit të Shkollës 9-vjeçare "35 Vjetori i Çlirimit", Gramsh, me emrin "Shkolla 9-vjeçare "Xhevit Dermyshi""**.

Këtij relacioni i bashkëlidhet propozimi i Kryetarit të Bashkisë dhe dokumentacioni shoqërues që argumenton figurën dhe kontributin e z. Xhevit Dermyshi.

Me konsideratë,

**KRYETARI**

**BESION AJAZI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA GRAMSH

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 308/1 Prot. /2 Gramsh, më 21.07.2026

**PROJEKT-VENDIM**
**Nr. ______, Datë ______.______. 2025**

**PËR**
**NDRYSHIMIN E EMËRTIMIT TË “SHKOLLËS 9-VJEÇARE “35 VJETORI I ÇLIRIMIT” ME EMRIN “SHKOLLA 9-VJEÇARE “XHEVIT DERMYSHI”**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9 pika 1/1.1, shkronja “b” dhe pika 1/1.7 shkronja “b”, nenit 54 shkronja “m” dhe nenit 55 pikat 2 dhe 6 të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; Ligjit Nr. 69/2012, datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar), në vijim të kërkesës së kryetarit të bashkisë, në relacionin shpjegues të administratës së Bashkisë Gramsh, si dhe pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur,

**VENDOSI:**

**1.** Të shprehë dakordësinë për emërtimin e “Shkollës 9-vjeçare “35 Vjetori i Çlirimit”, Gramsh, me emrin “Shkolla 9-vjeçare “Xhevit Dermyshi”, në nderim të kontributit të tij të shquar në arsimin dhe jetën qytetare të Gramshit.
**2.** Të ngarkojë Kryetarin e Bashkisë Gramsh që, në bashkëpunim me institucionin vendor përgjegjës për arsimin parauniversitar dhe drejtuesin e shkollës, të ndjekë procedurën përkatëse pranë autoritetit shtetëror kompetent.
**3.** Zbatimi i emërtimit në dokumentacionin zyrtar, regjistrat, vulat, tabelat e identifikimit dhe sistemet elektronike të bëhet vetëm pas përfundimit të procedurës dhe nxjerrjes së aktit nga autoriteti kompetent, sipas legjislacionit në fuqi.
**4.** Shpenzimet e mundshme administrative për zbatimin e emërtimit të përballohen sipas legjislacionit dhe mundësive buxhetore të miratuara.
**5.** Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

SEKRETARI I KËSHILLIT TË BASHKISË
Xhulia GJINI

KRYETARI I KËSHILLIT TË BASHKISË
Enis ZANI

Adresa: Sheshi “Kamber Dermyshi” Bulevardi “10 Korriku” E-mail: bashkia.gramsh@bashkiagramsh.gov.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 303/1/2 Prot. Gramsh, më 21.07.2026

**PROJEKT-VENDIM**
**Nr. ______, Datë ______.______. 2025**

**PËR**
**NDRYSHIMIN E EMËRTIMIT TË "SHKOLLËS 9-VJEÇARE "35 VJETORI I ÇLIRIMIT" ME EMRIN "SHKOLLA 9-VJEÇARE "XHEVIT DERMYSHI"**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9 pika 1/1.1, shkronja "b" dhe pika 1/1.7 shkronja "b", nenit 54 shkronja "m" dhe nenit 55 pikat 2 dhe 6 të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore"; Ligjit Nr. 69/2012, datë 21.06.2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar), në vijim të kërkesës së kryetarit të bashkisë, në relacionin shpjegues të administratës së Bashkisë Gramsh, si dhe pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur,

**VENDOSI:**

**1.** Të shprehë dakordësinë për emërtimin e "Shkollës 9-vjeçare "35 Vjetori i Çlirimit", Gramsh, me emrin "Shkolla 9-vjeçare "Xhevit Dermyshi", në nderim të kontributit të tij të shquar në arsimin dhe jetën qytetare të Gramshit.
**2.** Të ngarkojë Kryetarin e Bashkisë Gramsh që, në bashkëpunim me institucionin vendor përgjegjës për arsimin parauniversitar dhe drejtuesin e shkollës, të ndjekë procedurën përkatëse pranë autoritetit shtetëror kompetent.
**3.** Zbatimi i emërtimit në dokumentacionin zyrtar, regjistrat, vulat, tabelat e identifikimit dhe sistemet elektronike të bëhet vetëm pas përfundimit të procedurës dhe nxjerrjes së aktit nga autoriteti kompetent, sipas legjislacionit në fuqi.
**4.** Shpenzimet e mundshme administrative për zbatimin e emërtimit të përballohen sipas legjislacionit dhe mundësive buxhetore të miratuara.
**5.** Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

SEKRETARI I KËSHILLIT TË BASHKISË
Xhulia GJINI

KRYETARI I KËSHILLIT TË BASHKISË
Enis ZANI

Adresa: Sheshi "Kamber Dermyshi" Bulevardi "10 Korriku" E-mail: bashkia.gramsh@bashkiagramsh.gov.al

**REPUBLIKA E SHQIPERISË**
**KËSHILLI BASHKIAK GRAMSH**
**SEKRETARI I KËSHILLIT**

**Nr 3047 prot.** **Gramsh, më 21 / 07 /2026**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË SEKRETARIA BASHKIA GRAMSH

## THIRRJE PËR MBLEDHJE

**KOMISIONI I DHËNIEVE TË MEDALJEVE DHE TITUJVE VENDOR TË NDERIT .**

Ditën e Mërkurë datë 22/07/2026 ora 10:30 në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak, bazuar në Ligjin 112/2013 "Për dekoratat, titujt e nderit , medaljet dhe titujt vendorë të nderit në RSH" në Ligjin 139/2015 datë 17.12.2019 neni 54 gërma (ll) dhe (m) neni 33 , neni 34 , neni 36 dhe neni 47 i Rregullores së Funksionimit të Këshillit të Bashkisë , si dhe VKB nr. 38 datë 29/05/2026 Për miratimin e Udhëzueasit "për dhënien e Titujve Vendor të Nderit" zhvillohet mbledhja e komisionit për të diskutuar çështjet si më poshtë:

1- **Propozim për vendosjen e emrit Xhevit Dermyshi "Shkollës 9-vjeçare "35- Vjetori I Çlirimit" , Gramsh**

**SEKRETAR I KËSHILLIT BASHKIAK**

**XHULIA GJINI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK
KOMISIONI I DHËNIEVE TË MEDALJEVE DHE TITUJVE VENDOR TË NDERIT

Nr.3044/2 Prot. Gramsh, më 22.07.2026

Raport

**Mbi shqyrtimin e projektvendimit "Për ndryshimin e emërtimit të Shkollës 9-vjeçare "35 Vjetori i Çlirimit" me emrin "Shkolla 9-vjeçare "Xhevit Dermyshi""**

Sot, më datë 22.07.2026, ora 10:30, në ambientet e Bashkisë Gramsh, salla e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak, u zhvillua mbledhja e Komisionit të Arsimit, Kulturës, Sporteve, Dhënies së Titujve dhe Informimit, me këtë rend dite:
**Shqyrtimi i projektvendimit "Për ndryshimin e emërtimit të Shkollës 9-vjeçare "35 Vjetori i Çlirimit" me emrin "Shkolla 9-vjeçare "Xhevit Dermyshi""**, paraqitur nga Kryetari i Bashkisë Gramsh.

**Në mbledhje morën pjesë:**

- Kryetari i Komisionit: Julj.. Dollon. [signature]
- Anëtar: Sofi Zoni [signature]
- Anëtar: Alketa Bici [signature]
- Anëtar: ____________
- Anëtar: ____________

Të ftuar:

- Kryetari i Bashkisë / përfaqësuesi i tij;
- Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Sociale;
- Përfaqësues të Drejtorisë Juridike;
- Sekretari i Këshillit Bashkiak.

**Shqyrtimi i materialit**

Komisioni, u njoh me relacionin dhe projektvendimin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë Gramsh, ku argumentohet nevoja për ndryshimin e emërtimit të institucionit arsimor, me qëllim nderimin e figurës së z. **Xhevit Dermyshi**, personalitet me kontribut të shquar në zhvillimin e arsimit në Bashkinë Gramsh.
Gjatë diskutimeve u evidentua se:

- propozimi mbështetet në legjislacionin në fuqi për vetëqeverisjen vendore dhe arsimin parauniversitar;
- z. Xhevit Dermyshi ka dhënë një kontribut të rëndësishëm në drejtimin dhe zhvillimin e institucioneve arsimore të Bashkisë Gramsh;
- emërtimi i shkollës me emrin e tij përfaqëson një vlerësim institucional dhe ruan kujtesën historike të komunitetit;

- projektvendimi nuk sjell pasoja të konsiderueshme financiare për buxhetin e Bashkisë, përveç shpenzimeve minimale administrative që lidhen me përditësimin e identifikimit të institucionit.

Anëtarët e Komisionit vlerësuan se propozimi është i argumentuar, përputhet me interesin publik dhe kontribuon në promovimin e figurave të spikatura të arsimit lokal.

**Vendimi i Komisionit**

Pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe diskutimeve të zhvilluara, Komisioni i Arsimit, Kulturës, Sporteve, Dhënies së Titujve dhe Informimit,

**VENDOSI:**

1. Të japë **mendim pozitiv** për projektvendimin "Për ndryshimin e emërtimit të Shkollës 9-vjeçare "35 Vjetori i Çlirimit" me emrin "Shkolla 9-vjeçare "Xhevit Dermyshi"".
2. T'i rekomandojë Këshillit Bashkiak Gramsh miratimin e projektvendimit dhe vijimin e procedurave ligjore pranë institucioneve kompetente, sipas legjislacionit në fuqi.
3. Ky procesverbal t'i bashkëlidhet dokumentacionit që do t'i paraqitet për shqyrtim Këshillit Bashkiak.

Mbledhja u mbyll në orën __________.

**KRYETARI I KOMISIONIT**

Juljeta Dolloni

**ANËTARËT**

1. Soli Zani
2. Alketa Bica
3. 
4. 

**SEKRETARI I MBLEDHJES**

Xhulio Gani

Adresa: Sheshi "Kamber Dermyshi" Bulevardi "10 Korriku" E-mail: bashkia.gramsh@bashkiagramsh.gov.al

(1)

22/07/2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
SEKRETARIA
Nr 7/1
[illegible] 2026

P/Verbal

Mbledhja në sallën e mbledhjeve, mbledhja e Komis. [illegible] [illegible] [illegible] [illegible] për [illegible] propozimin e K. Bashkiak për emërtimin e shkollës "9-vjeçare [illegible]" Gramsh me emrin [illegible] [illegible].

[illegible] B: [illegible] shkolla [illegible] [illegible], me propozim [illegible] [illegible] [illegible] [illegible] kësaj shkolle emri i [illegible] [illegible] [illegible] [illegible] [illegible] [illegible] [illegible] [illegible] [illegible] [illegible] [illegible] [illegible] [illegible] [illegible] [illegible] propozimi [illegible]

[illegible] D: Me [illegible] [illegible] [illegible] në [illegible] [illegible] propozimi, [illegible] [illegible] [illegible] në [illegible] e [illegible] [illegible] [illegible] shkolla e [illegible] [illegible] [illegible], emrit që [illegible] [illegible]. [illegible] [illegible] [illegible] propozimin.

A.B- [illegible] [illegible] [illegible] [illegible]

[illegible] [illegible] shkolla emrin e [illegible].

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
KRYETARI

Nr 3036 Prot Gramsh më 20 /07/2026

***RELACION***
***PËR***
**SHPËRNDARJEN E FONDIT TE PAKUSHTËZUAR SHTESË.**

Të nderuar këshilltarë!

Mbështetur në nenin 9 pika 1.3 shkronja "c", 30, 41, 54 shkronja "dh" të ligjin 139/2015 datë 17.12.2015 "Për qeverisjen vendore"; kreu III nenet 10-20, kreu IV "nenett 22-29, kreu VII nenet 39-41 në ligjin Nr .68 /2017 datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", ligjin Nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar; ligjin Nr.10 296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"(i ndryshuar); udhëzimin nr 9 datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr. 2 datë 14.01.2026 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2026, VKB nr. 105 datë 29.12.2025 " Për miratimin e programit buxhetor për vitin 2026, Aktin Normativ Nr. 2 datë 06.07.2026 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 87/2025 "për buxhetin e vitit 2026" i ndryshuar

Në Aktin Normativ Nr. 2 datë 30.06.2026 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 87/2025 për buxhetin e vitit 2026" i ndryshuar Bashkisë Gramsh i është akorduar një grand shtesë prej 1,118,586 lekë, transfertë kjo shtesë e grandit të pakushtëzuar.

Sa më sipër propozojmë që grandi i mësipër të shpërndahet/përdoret për bonus qeraje financuar nga Bashkia Gramsh në shumën 1,118,586 lekë

Faleminderit.

**Drejtori Ekonomik**
**Ermal Hysa**

**Kryetari i Bashkise**
**Besion Ajazi**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA GRAMSH

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**KËSHILLI BASHKIAK**
**GRAMSH**

Nr 3036 prot

Gramsh 20 /07/2026

# P / V E N D I M

Nr dt. . .2026

## PËR
## SHPËRNDARJEN E FONDIT TE PAKUSHTËZUAR SHTESË.

Këshilli i Bashkisë Gramsh, në mbledhjen e tij të datës __.07.2026 , pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëset "Për shpërndarjen e fondit të pakushtëzuar shtesë", mbështetur në nenin 9 pika 1.3 shkronja "c", 30, 41, 54 shkronja "dh" të ligjin 139/2015 datë 17.12.2015 "Për qeverisjen vendore"; kreu III nenet 10-20, kreu IV "nenett 22-29, kreu VII nenet 39-41 në ligjin Nr .68 /2017 datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", ligjin Nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar; ligjin Nr.10 296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"(i ndryshuar); udhëzimin nr 9 datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr. 2 datë 14.01.2026 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2026, VKB nr. 105 datë 29.12.2025 " Për miratimin e programit buxhetor për vitin 2026, Aktin Normativ Nr. 2 datë 06.07.2026 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 87/2025 "për buxhetin e vitit 2026" i ndryshuar.

## V E N D O S I

**I.** Të përdoret Fondi i pakushtëzuar shtresë sipas Aktrit Normativ Nr 2 datë 30.10.2026 në shumën 1,118,586 lekë e ndarë si më poshtë:

1. Të përdoren për bonus qeraje financuar nga Bashkia Gramsh në shumën 1,118,586 lekë.

**II.** Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria e Financës dhe Buxhetit.

**III.** Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**Sekretari i Keshillit**
**Xhulia Gjini**

**Kryetari i Këshillit Bashkiak**
**Enis Zani**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**KESHILLI BASHKIAK**
**GRAMSH**

Nr.3039 Prot                                        Gramsh më 20/07/2026

**PROJEKT-VENDIM**
**Nr ____ Date ___/___/2026**

**PËR**
**DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE PER MUAJIN QERSHOR 2026 (FONDI 6%)**

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës ___/___/ 2026,pasi mori në shqyrtim projekt-vendimin e Drejtorisë së Shërbimeve dhe Mbrojtjes Sociale,Sektori i Ndihmës Ekonomike dhe Aftësisë së Kufizuar " Për dhënien e ndihmës Ekonomike nga fondi 6% për muajin **qershor2026**" mbeshtetur në Ligjin Nr 57 dt 18.07.2019 "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë,Neni 21;*VKM Nr.597 datë 04.09.2019 si dhe në* Ligjin Nr. 139/2015 datë 17.12.2015 "Për veteqeverisjen vendore"neni 8,pika 2;neni 9 ,pika 1.1/a dhe 1.1/b si dhe neni 54 pika ( k) dhe (n);

**VENDOSI:**

1 **Të përfitojnë Ndihmë Ekonomike 38 familje me një fond prej 174.519 lekë sipas tabelës së mëposhtme:**

| Njësia administrative | Nr | Emri i Aplikantit | NID | Nr Aplikimit | Statusi aplikimit | Vlera e llogaritur për fondin 6% | Kompensimi i Energjisë | Totali | Nr anëtarëve |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Gramsh | 1 | Qazime Rustem Meta | G05725070E | NE-2021-024062 | Rekomanduar per trajtim me fondin 6 % | 2178.00 | 1288.00 | 3466.00 | 2 |
| | 2 | Bujar Ali Qyra | H10123023D | NE-2024-021807 | Rekomanduar per trajtim me fondin 6 % | 0.00 | 1288.00 | 1288.00 | 1 |
| | 3 | Leonora Zahmeti Dragoti | H75416201B | NE-2024-024807 | Rekomanduar per trajtim me fondin 6 % | 2178.00 | 1288.00 | 3466.00 | 2 |
| | 4 | Fiqirete Pellumb Vela | G76227112Q | NE-2025-005392 | Rekomanduar per trajtim me fondin 6 % | 2178.00 | | 2178.00 | 1 |
| | 5 | Rudina Veli Huta | I55910079O | NE-2025-008967 | Rekomanduar per trajtim me fondin 6 % | 7920.00 | | 7920.00 | 3 |
| | 6 | Izaura Artur Dulja | I75626114L | NE-2025-014765 | Rekomanduar per trajtim me fondin 6 % | 5940.00 | | 5940.00 | 2 |
| | 7 | Alma Muharrem Brahimi | H35108049C | NE-2025-016679 | Rekomanduar per trajtim me fondin 6 % | 2178.00 | | 2178.00 | 1 |
| | 8 | Arta Ramazan Latollari | H15107044B | NE-2025-019718 | Rekomanduar per trajtim me fondin 6 % | 3703.00 | 1288.00 | 4991.00 | 2 |
| | 9 | Besjana Kujtim Hoxha | J15606107P | NE-2025-019723 | Rekomanduar per trajtim me fondin 6 % | 2178.00 | | 2178.00 | 1 |
| | 10 | Roland Faik Rrengo | H41125140O | NE-2025-023427 | Rekomanduar per trajtim me fondin 6 % | 2178.00 | | 2178.00 | 1 |

Adresa: Sheshi "Kamber Dermyshi" Bulevardi "10 Korriku" Tel.Fax:0513 2 2272 E-mail: bashkia.gramsh@bashkiagramsh.gov.al

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 11 | Greta Skënder Çela | J06120014C | NE-2025-024940 | Rekomanduar per trajtim me fondin 6 % | 5940.00 | | 5940.00 | 2 |
| | 12 | Ezmira Abedin Kasmi | I75904026T | NE-2026-000250 | Rekomanduar per trajtim me fondin 6 % | 12672.00 | | 12672.00 | 5 |
| | 13 | Flora Shyqo Haxhia | G65407150A | NE-2026-000925 | Rekomanduar per trajtim me fondin 6 % | 3146.00 | | 3146.00 | 1 |
| | 14 | Dritan Shefit Berdellima | H00107065M | NE-2026-005926 | Rekomanduar per trajtim me fondin 6 % | 2178.00 | | 2178.00 | 1 |
| | 15 | Eliana Besim Leshi | J15529097A | NE-2026-008523 | Rekomanduar per trajtim me fondin 6 % | 6732.00 | | 6732.00 | 4 |
| | 15 | **Total Njësia Administrative: Gramsh** | | | | 61299.00 | 5152.00 | 66451.00 | 29 |
| Kodovjat | 1 | Fiqiri Nazif Dhëmbi | H40317016W | NE-2025-010122 | Rekomanduar per trajtim me fondin 6 % | 6752.00 | 1288.00 | 8040.00 | 4 |
| | 1 | **Total Njësia Administrative: Kodovjat** | | | | 6752.00 | 1288.00 | 8040.00 | 4 |
| Kushove | 1 | Naxhire Selim Bora | H15405044A | NE-2023-014161 | Rekomanduar per trajtim me fondin 6 % | 2178.00 | | 2178.00 | 1 |
| | 2 | Rajmonda Ramadan Kapllani | H05607077O | NE-2023-014787 | Rekomanduar per trajtim me fondin 6 % | 2178.00 | | 2178.00 | 1 |
| | 3 | Thoma Xhaferr Bora | G91012048I | NE-2025-022133 | Rekomanduar per trajtim me fondin 6 % | 5227.00 | 1288.00 | 6515.00 | 3 |
| | 3 | **Total Njësia Administrative: Kushove** | | | | 9583.00 | 1288.00 | 10871.00 | 5 |
| Pishaj | 1 | Nuri Myftar Kotorri | F70116003E | NE-2018-007419 | Rekomanduar per trajtim me fondin 6 % | 3703.00 | 1288.00 | 4991.00 | 2 |
| | 2 | Naxhije Mustafa Çela | G55209131P | NE-2024-021348 | Rekomanduar per trajtim me fondin 6 % | 3146.00 | | 3146.00 | 1 |
| | 3 | Ramazane Rexhep Ahmati | F85605013F | NE-2024-022412 | Rekomanduar per trajtim me fondin 6 % | 3146.00 | | 3146.00 | 1 |
| | 4 | Lirije Banush Mesiti | G45505047G | NE-2025-001690 | Rekomanduar per trajtim me fondin 6 % | 3146.00 | 1288.00 | 4434.00 | 1 |
| | 5 | Shpresa Luman Kovaçi | F95712015O | NE-2025-014973 | Rekomanduar per trajtim me fondin 6 % | 3146.00 | 1288.00 | 4434.00 | 1 |
| | 6 | Drita Kasem Kula | G65404201E | NE-2025-015194 | Rekomanduar per trajtim me fondin 6 % | 3146.00 | 1288.00 | 4434.00 | 1 |
| | 7 | Ervin Ali Paja | I90903018P | NE-2025-021004 | Rekomanduar per trajtim me fondin 6 % | 8712.00 | | 8712.00 | 5 |
| | 8 | Flora Muharrem Shurdha | G65125048M | NE-2025-024935 | Rekomanduar per trajtim me fondin 6 % | 3146.00 | 1288.00 | 4434.00 | 1 |
| | 8 | **Total Njësia Administrative: Pishaj** | | | | 31291.00 | 6440.00 | 37731.00 | 13 |
| Sult | 1 | Abedin Dule Miraka | F81021007P | NE-2017-058523 | Rekomanduar per trajtim me fondin 6 % | 3703.00 | 1288.00 | 4991.00 | 3 |
| | 2 | Nefail Refit Verça | G40920013H | NE-2022-021711 | Rekomanduar per trajtim me fondin 6 % | 3049.00 | 1288.00 | 4337.00 | 3 |
| | 3 | Fatushe Osman Jança | F45522018I | NE-2025-017667 | Rekomanduar per trajtim me fondin 6 % | 3049.00 | | 3049.00 | 2 |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 4 | Haki Hysen Dermyshi | F70220047S | NE-2025-025098 | Rekomanduar per trajtim me fondin 6 % | 3703.00 | 1288.00 | 4991.00 | 2 |
| | 4 | **Total Njësia Administrative: Sult** | | | | 13504.00 | 3864.00 | 17368.00 | 10 |
| Tunje | 1 | Leonard Barjam Miraka | I40830016L | NE-2023-016345 | Rekomanduar per trajtim me fondin 6 % | 5881.00 | | 5881.00 | 4 |
| | 2 | Resmije File Murati | F76031002L | NE-2024-011999 | Rekomanduar per trajtim me fondin 6 % | 3146.00 | 1288.00 | 4434.00 | 1 |
| | 3 | Çaush Feta Hoxha | G90620031B | NE-2024-015424 | Rekomanduar per trajtim me fondin 6 % | 2178.00 | 1288.00 | 3466.00 | 2 |
| | 4 | Hysen Barjam Barçi | G20212034M | NE-2024-015576 | Rekomanduar per trajtim me fondin 6 % | 3703.00 | 1288.00 | 4991.00 | 2 |
| | 5 | Xhevair Mehdi Tabaku | F20824006P | NE-2024-016503 | Rekomanduar per trajtim me fondin 6 % | 3049.00 | 1288.00 | 4337.00 | 3 |
| | 6 | Dritan Riza Miraka | H20330016Q | NE-2024-016640 | Rekomanduar per trajtim me fondin 6 % | 5227.00 | 1288.00 | 6515.00 | 3 |
| | 7 | Hava Tahir Salla | F85129033J | NE-2025-021481 | Rekomanduar per trajtim me fondin 6 % | 3146.00 | 1288.00 | 4434.00 | 1 |
| | 7 | **Total Njësia Administrative: Tunje** | | | | 26330.00 | 7728.00 | 34058.00 | 16 |
| **Total Bashkia: Gramsh** | 38 | | | | | 148759.00 | 25760.00 | 174519.00 | 77 |
| | 38 | | | | | 148759.00 | 25760.00 | 174519.00 | 77 |

**Dr.Drej.Shërbimeve dhe Mbrojtjes Sociale**
**Elisabeta Xhepexhiu**

**Dr.Drej. Finances dhe Buxhetit**
**Ermal Hysa**

**Sekretari Keshillit**
**Xhulia Gjini**

**Kryetari Keshillit**
**Enis Zani**